

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shehu shpjegon prapavijën e “parashikimeve” të Vuçiqit për Gjykatën Speciale
ADRESA	https://albeu.com/kosove/shehu-shpjegon-prapavijen-e-parashikimeve-te-vuciqit-per-gjykat-en-speciale/1010097/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:46:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 19:18:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	25301b49c37b71c1edd3f54a32e080706105a9a39166e7bc5362ad7eb755934f
TEKSTI	ea1a6aa486039daff05d1ea8edf5b88c1a6ff2b453fd576933c73f20ad770682
PAMJA	88bcbdb334f8bb65570d87c52cb7ffac9a03830ecea09dc73964e30989a8e83a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	925ea692d194f817df999d06944415eccc6db74e051ba5cd278a53462e646152
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/925ea692d194f817df999d06944415eccc6db74e051ba5cd278a53462e646152>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shehu shpjegon prapavijën e “parashikimeve” të Vuçiqit për Gjykatën Speciale



Nexhmedin Shehu, publicist, ka thënë për “Bota sot” se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mban në vazhdimësi një qëndrim armiqësor ndaj Kosovës.

Ai vlerëson se deklaratimet e Vuçiqit rreth aktgjykimit të Gjykatës Speciale synojnë të nxisin reagime qytetare në Kosovë dhe të dëmtojnë imazhin e vendit, në mënyrë që ai ta paraqesë atë si të barabartë me Serbinë.

Sipas Shehut, synimet armiqësore të Aleksandar Vuçiqit kundër Kosovës janë të përhershme dhe të padiskutueshme. Ai thotë se ato paraqiten në forma të ndryshme, të përgatitura zakonisht me kujdes, në mënyrë që të mos mbeten dëshmi të drejtpërdrejta për qëllimin e vërtetë. Nisur nga kjo, sipas tij, duhen shqyrtuar edhe “parashikimet” e presidentit serb për vendimin e Gjykatës Speciale.

Shehu thekson se loja e Vuçiqit me këto “parashikime” nuk është e rastësishme: fillimisht ai paralajmëroi lirimin e Thaçit, ndërsa tani flet për një dënim të rëndë, duke pretenduar në të dyja rastet se mbështetet te burime të “mirinformuara”. Sipas publicistit, kjo është pjesë e një platforme që synon të provokojë reagim qytetar në Kosovë.

Një reagim i pakontrolluar, sipas tij, do t'i shërbente propagandës së Vuçiqit. Në këtë mënyrë, vëmendja do të largohej nga nderimet që Serbia i bëri kriminelit të dënuar të luftës, Ratko Mladiq, ndërsa presidentit serb do t'i krijohet mundësia ta barazonte Kosovën me sjelljen antivilizuese të shtetit serb.

të fundit /



Shehu shpjegon prapavijën e “parashikimeve” të...



Ardit Nikaj shkëlqen me dopietë në fitoren e Elbasanit: Jemi...



Pas dasmës luksoze, këngëtarja e njohur Kida nis muajin e...



Nevil Dede pas disfatës 2-1 ndaj Elbasanit: Humbjet janë pjesë e...



Derbi i Anamoravës mbyllet pa gola, Drita dhe Gjilani ndahen m...



Gvozdenovic pas suksesit ndaj Egnatias: E gjeta ilaçin për...




Prishtina regjistron fitoren e pestë radhazi, Fazlija shënon në...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium





Publicisti thotë se veprimet e Vuçiqit kundër Kosovës nuk mund të konsiderohen të rastit, por janë pjesë e një politike të vazhdueshme që ka për synim dëmtimin e stabilitetit të saj dhe të imazhit që ajo gëzon në arenën ndërkombëtare.

Shehu shpjegon se, në një botë të ndërlidhur, varësia dhe ndikimi i ndërsjellë i veprimeve politike shihen qartë si mes miqve, ashtu edhe mes kundërshtarëve. Aq më pak, sipas tij, mund të besohet se veprimet e Vuçiqit nuk kanë prapavijë politike, kur bëhet fjalë për dy shtete fqinje me një histori të rëndë armiqësish.

Ai nënvizon se politika e presidentit serb mbart një objektiv të pandryshueshëm: të dëmtojë gjithçka që lidhet me Kosovën, duke nisur nga qëndrueshmëria e brendshme e deri te reputacioni dhe pozita e saj ndërkombëtare.

Për këtë arsye, Shehu u kërkon institucioneve të Kosovës, partive politike, individëve dhe sidomos mjeteve të informimit që ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre. Pavarësisht se cili do të jetë aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ai kërkon që reagimi të mbetet i matur, dinjitoz dhe demokratik.

Sipas tij, vetëm një qasje e tillë e mbron dinjitetin e Kosovës si pjesë e pandashme e Europës dhe si përfaqësuese e vlerave europiane, ku përfshihen respektimi i drejtësisë dhe kundërshtimi i padrejtësive nëpërmjet rrugëve ligjore.

Shehu ka bërë thirrje të shmangët çdo akt dhune ose cenim i rendit, pasi një reagim i tillë, sipas tij, do t'u shërbente Vuçiqit dhe kundërshtarëve të Kosovës.

Ai paralajmëron se çdo veprim i dhunshëm do të ishte i pafalshëm, sepse do t'i jepte Vuçiqit pikërisht mundësinë që kërkon: ta paraqesë Kosovën si të barabartë me Serbinë në raport me drejtësinë ndërkombëtare dhe krimet e luftës.

Në rast se drejtësia mungon në gjykimin e katër ish-udhëheqësve të UÇK-së, Shehu thotë se ajo duhet të kërkohej me vendosmëri, në mënyrë demokratike dhe duke përdorur të gjitha mjetet ligjore.

Në përmbyllje të deklaratës për "Bota sot", ai thekson se protesta paqësore, fjala e lirë dhe kritika e mbështetur në argumente janë të patjetërsueshme, ndërsa dhuna dhe provokimet do të favorizojnë vetëm Vuçiqin dhe kundërshtarët e Kosovës.

Shtuar më 13.09.2026 21:18

Tags: [haga](#) , [Nexhmedin](#) , [Sheh](#) , [specialja](#)



Këta janë 15 kandidatët që pritet të marrin mandatet e ministrave të Qeverisë K...



BSPK kërkon zbatimin e zotimeve qeveritare për punëtorët



PDK-ja të hënën kërkon interpretim nga Kushtetuesia për



Kurti i kërkon PDK-së të propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit



Mediat ndërkombëtare pasqyrojnë votimin e Qeverisë "Kurti 4



"Serbia kreu gjenocid ndaj shqiptarëve"/ Kurti për procesin në Hagë: Asnjë...



Kurti: Qeveria e re do t'i shërbejë qytetarit dhe do të mbrojë familjen



OVL-UÇK: Ndërkombëtarët të mos ndërhyjnë politikisht në vendimin e 16 shtatori...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.